

# Raport

pilot project

IDENTIFIKIMI HAPËSINOR I  
NDOTËSVE  
POTENCIAL

# 2008


PRISHTINË — FUSHË KOSOVË — KASTRIOT



Prishtinë, 2008



## Identifikimi Hapësinor i Ndotësve Potencial - 2008



RAPORT: IDENTIFIKIMI HAPËSINOR I NDOTËSVE POTENCIAL  
2008 – 2009

BOTUES: MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR  
AGJENCIA E KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

REALIZOI: SISTEMI INFORMATIV MJEDISOR

KONTRIBUES: DREJTORIA E HARTIMIT TË RAPORTEVE DHE PROGRAMEVE  
MJEDISORE  
DREJTORIA PËR MONITORIM MJEDISOR  
ZYRTARËT MJEDISOR PRAN KOMUNAVE

LEKTOR: TONE GASHI

DIZAJN: SISTEMI INFORMATIV MJEDISOR

BALLINA: SISTEMI INFORMATIV MJEDISOR

## PËRMBAJTJA

|                                                            |           |
|------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>1. Parathënie .....</b>                                 | <b>4</b>  |
| <b>2. Hyrje .....</b>                                      | <b>5</b>  |
| <b>3. Metoda e punës .....</b>                             | <b>6</b>  |
| <b>4. Baza e të dhënave .....</b>                          | <b>7</b>  |
| <b>5. Baza e të dhënave në GIS .....</b>                   | <b>8</b>  |
| <b>6. Aspekti gjeografik .....</b>                         | <b>8</b>  |
| 5.3. Komuna e Prishtinës .....                             | 9         |
| 5.1. Komuna e Fushë Kosovës .....                          | 11        |
| 5.2. Komuna e Kastriot.....                                | 12        |
| <b>6. Rezultatet .....</b>                                 | <b>13</b> |
| 6.1. Numri dhe llojet e ndotësve sipas komunave .....      | 13        |
| 6.2. Klasifikimi i ndotësve sipas sektorëve ekonomik ..... | 15        |
| 6.3. Ndotja e ajrit .....                                  | 18        |
| 6.4. Ndotja e ujit .....                                   | 23        |
| 6.5. Ndotja e tokës .....                                  | 26        |
| 6.6. Menaxhimi i mbeturinave .....                         | 27        |
| <b>7. Rekomandimet .....</b>                               | <b>29</b> |

## 1. PARATHËNIE

Gjendja e mjedisit dhe përkujdesja ndaj tij janë ndër problemet dhe sfidat më të mëdha të njerëzimit sot. Padyshim, zhvillimi i industrisë është njeri prej faktorëve kryesorë që ka ndikim në kualitetin e mjedisit.

Zhvillimi ekonomik i cili po shoqërohet me rritje të vazhdueshme të numrit të ndërmarrjeve operuese, si rrjedhojë ka edhe rritjen e ndikimit në mjedis. Varësisht prej veprimtarisë, ndikimi i operatorëve ekonomik është i shprehur në të gjithë përbërësit e mjedisit si në ajër, ujë dhe në tokë.

Mungesa e filtrave në oxhaqet e operatorëve ekonomik, lirimi i gazrave të ndryshme nga gjeneratorët (numri i përdorimit të tyre momentalisht në Kosovë është mjaft i madh), ndikon në ndotjen e ajrit. Mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza komunale dhe industriale ka ndikim në ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Deponitë komunale, industriale, mbeturinat metalike dhe të automjeteve, si dhe shkarkimi i ujërave të zeza individuale dhe industriale, janë burim i ndotjes. Më qëllim të krijimit të bazës së të dhënave dhe pasqyrimin real të gjendjes së mjedisit në terren, AKMM gjatë vitit 2008, ka filluar procesin e inventarizimit të ndotësve potencial në Kosovë.

Fillimisht, ky proces ka nisur si pilot projekt për inventarizimin e potencialeve ndotëse në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë dhe Kastriot, si aglomeracion i cili mund të konsiderohet si hapësira më e ndotur në vend.

## 2. HYRJE

Raporti për identifikimin e ndotësve potencial në aglomeracionin hapësinor: Prishtinë, Fushë-Kosovë dhe Kastriot është realizuar me qëllim që të krijohet një pasqyrë e qartë për numrin e aktiviteteve socio-ekonomike të cilat kanë ndikim në mjedis, ose paraqesin potenciale ndotëse për mjedisin. Duke iu referuar bazës së të dhënave mbi regjistrimin e bizneseve është bërë selektimi i operatorëve ekonomik(OE), të cilët janë regjistruar si veprimtari me potencial ndotës. Duke u bazuar në këtë rezultat se numri i bizneseve të regjistruara me veprimtari me potencial ndotës është shumë i madh, mirëpo gjendja në terren ndryshon dukshëm si pasojë e mosfunksionimit të të gjitha bizneseve, si dhe ndryshimit të veprimtarisë sipas aktiviteteve.

Hulumtimi është rezultat i punës së ekipeve në terren, të krijuara në bashkëpunim të ngushtë në mes të drejtorisë së SIM – it dhe sektorëve për mbrojtjen e mjedisit nga komunat e përfshira në hulumtim.

Mbledhja e shënimeve nga kompanitë e lartpërmendura është bërë duke vizituar objektet të cilat llogariten të jenë ndotës potencial. Nga këto kompani janë plotësuar edhe formularët e përgatitur nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit. Me informatat e grumbulluara është ndërtuar baza e të dhënave për vendndodhjen e ndotësit, lokacionin, komunën, emrin, udhëheqësin, mënyrën e ndotjes, shkarkimin e ndotjes në ujë, ajër, tokë, adresën, numrin e telefonit dhe të dhëna tjera të rëndësishme.

Edhe përkundër vështirësive të paraqitura gjatë punës në terren, është arritur që projekti për identifikimin e ndotësve potencial në komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës dhe të Kastriot të përfundohet më sukses, dhe pritet fillimi i punëve për identifikimin e ndotësve edhe në komunat e tjera.

### 3. METODA E PUNËS

Identifikimi i ndotësve në terren është realizuar përmes vizitave në secilin objekt i cili është konsideruar si veprimtari me potencial ndotës. Mbledhja e të dhënave për këto aktivitete është realizuar duke plotësuar pyetësorin i cili është i ndarë në gjashtë fusha kryesore.

1. Të dhëna të përgjithshme për kompaninë - 11 pyetje
2. Shkarkimet në ajër - 4 pyetje
3. Shkarkimet në ujë - 3 pyetje
4. Shkarkimet në dhe - 1 pyetje
5. Deponitë e mbeturinave - 3 pyetje
6. Hot-spote potenciale - 3 pyetje

Të gjitha pyetjet e përpiluara kanë edhe informacione mbi shtrirjen hapësinore të aktiviteteve me potencial ndotës. Realizimi i pyetësorit në pjesën e të dhënave hapësinore është mundësuar duke shfrytëzuar pajisje të avancuara (GPS), si dhe janë krahasuar me hartat topografike dhe incizimit ajrore.



Foto 1. Mbledhja e të dhënave në terren

#### 4. BAZA E TË DHËNAVE

Pas realizimit të punës në terren SIM, përkatësisht sektori i bazës së të dhënave në bashkëpunim me sektorin e GIS-it, kanë përgatitur bazën e shënimeve në MS Access të lidhur me GIS, e cila mundëson futjen direkt të të dhënave nga pyetësi në aplikacion, si dhe njëkohësisht mundëson edhe pamjen e tyre hapësinore përmes GIS. Aplikacioni i bazës së të dhënave me titull **“Identifikimi Hapësinor i Ndotësve Potencial”** është i përberë nga gjithsej tetë module, me nën-module varësisht nga fushat dhe numri i pyetjeve.

Aplikacioni është shumë praktik dhe mundëson qasje selektive sipas natyrës së aktivitetit dhe të dhënave të dëshiruara. Gjithashtu aplikacioni përmban edhe modulën e raporteve të ndara në nën-module sipas veprimtarisë, aktiviteteve dhe shtrirjes hapësinore.

Aplikacioni




Figura 1. Baza e të dhënave në Access

#### 4. BAZA E TË DHËNAVE NË GIS

Të gjitha të dhënat e mbledhura nga terreni dhe të futura në aplikacionin e ndërtuar në MS Access, janë të shfrytëzueshme edhe në GIS, duke krijuar mundësinë e analizës sipas shpërndarjes hapësinore të aktiviteteve ekonomike me potencial ndotës. Këto të dhëna mund të analizohen dhe nga aspekti hapësinor duke treguar shtrirjen hapësinore të tyre me të gjitha informacionet përcjellëse.




Figura 2. Baza e të dhënavë në GIS

## 5. ASPEKTI GJEORAFIK

### 5.1. KOMUNA E PRISHTINËS

Komuna e Prishtinës shtrihet në pjesën lindore të Kosovës në gjerësi gjeografike prej  $42^{\circ}, 40', 00''$  dhe gjatësi gjeografike prej  $21^{\circ} 20' 15''$  (qyteti). Ndodhet në lindje të pjesës qendrore të Fushës së Kosovës me një sipërfaqe prej 572 km<sup>2</sup> në kuadër të cilës hyjnë 48 vendbanime. Pozita e përshtatshme gjeografike e qytetit të Prishtinës qëndron në faktin se ajo gjendet në udhëkryqin e rëndësishëm të rrugëve magjistrale, automobilistike, hekurudhore dhe ajrore.

Prishtina karakterizohet si qendër kryesore që ndërlidhë qytetet e Kosovës si dhe qendrat më të mëdha të Ballkanit. Qyteti shtrihet në luginën e lumenjve të vegjël Prishtina dhe Vellusha, në lartësi mbidetare mes 550-670m. Qyteti është zgjeruar në kodrinat përreth dhe ka tendencë zgjerimi në të gjitha drejtimet, por me intensitet më

të shprehur në drejtim jug-perëndimor, drejtimi i Fushës së Kosovës dhe atë jug-lindor në drejtim të Lypjan-it. Në territorin e komunës së Prishtinës dominon relievi kodrinor-malor i cili përfshin pjesën lindore, verilindore dhe juglindore të komunës, ndërsa në pjesën perëndimore territori i komunës shtrihet në fushën e Kosovës.



Harta 1. Pozita gjeografike e komunës së Prishtinës

Nga viti 1981 nuk ka pasur regjistrim të popullsisë në Kosovë. Pas luftës së fundit, Prishtina është mbingarkuar me popullatë. Në mungesë të regjistrimit të popullsisë që nga viti 1981 manipulohet me shifra mbi numrin e popullsisë së komunës. Duke u mbështetur në vlerësime dhe analiza të ndryshme mendohet se qytetarë rezident vetëm në qytetin e Prishtinës, janë përafërsisht 350 mijë, ndërsa, nëse llogariten edhe fshatrat shifra arrin deri 400 mijë banorë.

## 5. ASPEKTI GJEORAFIK

### 5.1. KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

Komuna e Fushë Kosovës shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës. Ndodhet rreth 8 kilometra në Jug-Perëndim të Prishtinës dhe është udhëkryq i rëndësishëm i rrugëve që lidhin pjesën lindore dhe perëndimore të Kosovës. Komuna e Fushë Kosovës (zona urbane) është edhe udhëkryq i rëndësishëm hekurudhor, ku është i vendosur stacioni qendror hekurudhor i Kosovës - Hekurudhat e Kosovës. Fushë Kosova shtrihet në një sipërfaqe prej 99 km<sup>2</sup> dhe ka mbi 40 mijë banorë. Pozita gjeografike si urë lidhëse në rrugën Prishtinë-Pejë, i jep kësaj komune mundësi shumë të mira të zhvillimit të bizneseve të vogla të llojeve të ndryshme. Para luftës komuna ka pasur disa objekte industriale si KBI “Miradia”, “Fabrika e Mishit”, të cilat pas privatizimit nuk

janë në funksion. Prej kapaciteteve industriale që zënë një vend shumë të rëndësishëm në ekonominë e komunës, vlen të përmendet Fabrika e Bukës “Kosovarja”. Gjithashtu duhet theksuar se një pjesë e zonës industriale të Prishtinës, gjendet në territorin e komunës së Fushë Kosovës.



**Harta 2.** Pozita gjeografike e komunës së Fushë Kosovës

## 5.2. KOMUNA E KASTRIOTIT

Komuna e Kastriot shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, me një sipërfaqe prej 105 km<sup>2</sup>. Ka pozitë të mirë gjeografike dhe lidhje hekurudhore të rëndësishme me Mitrovicën dhe Shkupin. Komuna e Kastriot përbëhet nga 23 vendbanime, me një popullsi e cila llogaritet mbi 32 mijë banorë. Është një komunë e pasur me ujë, që është bazë e rëndësishme për zhvillim ekonomik. Ka tre lumenj jo të mëdhenj: Llapi, Drenica, Sitnica, si dhe sistemin e ujitjes nga Ibri. Dukuri mjaft shqetësuese është ndotja e vazhdueshme e këtyre lumenjve.

Komuna e Kastriot është një ndër qendrat më të mëdha industriale në Kosovë, duke iu falënderuar rezervave të mëdha të



thëngjillit dhe objekteve të KEK-ut, termocentraleve "Kosova A" dhe "Kosova B", objekte këto shumë të rëndësishme industriale dhe energjetike për tërë Kosovën.

Në territorin e kësaj komune pritët të ndërtohet edhe termocentrali "Kosova e Re", projekt ky i Qeverisë së Kosovës.

Harta 3.:Pozita gjeografike e komunës së Kastriotit

## 6. REZULTATET

### 6.1. NUMRI DHE LLOJET E NDOTËSVE SIPAS KOMUNAVE

Në bazë të regjistrit të bizneseve nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, shkurt 2008, në territorin aglomeracionit hapësinor të përzgjedhur për hulumtim janë të regjistruara gjithsejtë 22223 biznese sipas veprimtarive të ndryshme:

1. Prishtinë - 19417
2. Fushë Kosovë - 1990
3. Kastriot - 816

Bazuar në regjistrin e lartshënuar, në komunën e Prishtinës janë të regjistruara 19417 operatorë ekonomik, në Fushë Kosovë janë 1990 operatorë ekonomik, kurse në komunën e Kastriotit 816 operatorë ekonomik.


Sipas kodeve të regjistrimit të bizneseve, si operatorë ekonomik me ndikim të mundshëm në mjedis, në aglomeracionin e hulumtuar janë gjithsejtë 4548 operatorë ekonomik. Në komunën e Prishtinës sipas kodeve të veprimtarive të regjistruara në MTI, kryejnë aktivitetet e tyre 4598 operatorë ekonomik, në Fushë Kosovë 163 dhe Kastriot 87 operatorë.

Ekipet e AKMM-së, gjatë punës në aglomeracionin e hulumtuar kanë evidentuar si objekte potenciale ndotëse gjithsejtë 191 operatorë ekonomik, prej tyre 129 në Prishtinë, 43 në Fushë Kosovë dhe 20 në Kastriot.

Objektet e vizituara kanë zhvilluar veprimtari të ndryshme ekonomike të cilat paraqesin mundësi të ndotjes potenciale të mjedisit siç janë:

- Hotelet
- Objektet për gjenerimin e nxehtësisë
- Auto larjet
- Objektet për riparimin e automjeteve, varreza makinash etj.
- Depo të karburanteve dhe pompa të benzinës
- Depo të materialeve të përgatitura për riciklim
- Fabrika për prodhimin e produkteve bujqësore
- Fabrika për përpunimin e ngjyrave, letrës etj
- Korporata Energjetike e Kosovës- KEK.

Vlen të theksohet se nga ekipet e AKMM-së, në secilin objekt të vizituar janë marrë të dhënat për: emrin e kompanisë, pronarin, personin kontaktues, koordinatat gjeografike për vendndodhjen e objektit, generatorit, tymtarit të ngrohjes qendrore, vendin e deponimit të mbeturinave (akumulatorëve, gomave, vajrave), vendin e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre atmosferike në kanalizimin e qytetit, seperatorët, rezervuarët mbi dhe nëntokësore të deponimit të karburanteve etj.



**Grafiku 2.** Numri i veprimtarive në Fushë Kosovë dhe Obiliq si potencial


## 6.2. KLASIFIKIMI I NDOTËSVE SIPAS SEKTORËVE EKONOMIK

Numri i përgjithshëm i aktiviteteve të identifikuara si ndotës potencial dhe që janë vizituara janë 186 veprimtari. Numrin më të madh të tyre e përbëjnë veprimtaritë hoteliere (30.6%), pikë karburanti (26.78%), autoservis & autolarje (21.86%), si dhe aktivitete tjera të cilat përbejnë grupe deri në 3% të aktiviteteve.


Nga puna në terren është vërtetuar se mbi 90% të veprimtarive zhvillojnë aktivitetet e tyre pa leje mjedisore dhe leje ujore. Është e rëndësishme të theksohet se edhe ai (10%) i aktiviteteve ekonomike që kanë pëlqim mjedisor dhe ujorë, duhet të aplikojnë për leje mjedisore dhe ujore.

**Tabela 1** Nr. OE me potencial ndotës

| Përshkrimi                            | Sasia      |
|---------------------------------------|------------|
| Autoservis & Autolarje                | 40         |
| Deponi e shitjes se pesticideve       | 1          |
| Deponi metalesh                       | 2          |
| Mulli & Fabrika e Bukës               | 4          |
| Fabrikë e ngjyrës                     | 1          |
| Fabrikë farmaceutike                  | 2          |
| Fabrikë mishi, thertore               | 2          |
| Hotel, Restorant                      | 56         |
| Industri ushqimore                    | 1          |
| KEK                                   | 3          |
| Kompani ndërtimore                    | 1          |
| Kompani për përpunimin e granitit     | 2          |
| Kompani për shpërndarjen e derivateve | 1          |
| Kompania Trafiku Urban                | 1          |
| Pastrim Kimik                         | 3          |
| Plastikë                              | 1          |
| Pikë karburanti                       | 50         |
| Prodhim dyer dhe dritare              | 2          |
| Shtypshkronje                         | 1          |
| Spital                                | 5          |
| Termokosi (tri lokacionet të veqanta) | 3          |
| Universitete                          | 4          |
| <b>Total</b>                          | <b>186</b> |



**Grafiku 3:** Numri i operatorëve ekonomik me potencial ndotës sipas veprimtarisë



**Harta 4.** Shpërndarja e ndotësve potencial në aglomeracionin e hulumtuar

### 6.3. NDOTJA E AJRIT

Burim kryesor i ndotjes së ajrit në aglomeracionin e hulumtuar është Korporata Energjetike e Kosovës. Ajri nga Termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B”, ndotet përmes tymtarëve dhe deponive të hirit. Gjithashtu ndotja në ditët me erë gjatë stinëve të vitit është e vazhdueshme, ku edhe përhapja e ndotjes varet nga shpejtësia dhe drejtimi i erës. Nga KEK-u, me përmasa më të vogla, ajri ndotet edhe gjatë transportimit të hirit për në deponi.

Përveç deponive të hirit dhe tymtarëve, në ndotjen e ajrit në këtë aglomeracio ndikojnë edhe: vatrat e zjarreve në mihjet sipërfaqësore, ngrohtoret e operatorëve ekonomik, gjeneratorët e operatorëve ekonomik me kapacitete të ndryshme, emisionet nga amvisëritë, depozitat e fenolëve etj. Numri më i madh i ngrohtoreve dhe gjeneratorëve si lëndë djegëse e përdorin naftën. Gjithashtu edhe pompat dhe rezervuarët e derivateve të naftës paraqiten si rrezik për ndotjen e ajrit, sidomos në rast të aksidenteve.






Foto 2. Ndotja e ajrit nga KEK-u




Grafiku 2. Sistemi i ngrohjes tek OE



**Harta 5.** Shpërndarja e vatrave të zjarrit, ngrohëtorëve dhe gjeneratorëve në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë dhe Kastriot

### TERMOCENTRALI "KOSOVA B"



#### LEGJENDA


- |                              |                       |
|------------------------------|-----------------------|
| ▲ Shkarkim i ujit industrial | ▲ Fabrikë             |
| ▲ Vatrë zjarri               | ■ Mbeturina shtëpiake |
| ○ Seperator                  | ■ Ngrohëtorë          |
| ▲ Rezervuar me lëndë djegëse | ▲ Depo                |
| ● Pusetë                     | ● Deponi              |
| ★ Punishte                   |                       |

Harta 6. Termocentrali "Kosova B"



## 6.4. NDOTJA E UJËRAVE

Sa i përket ujërave të zeza, qasje në kanalizim kanë 109 operatorë ekonomik, 13 i shkarkojnë ujërat drejtpërdrejt në lumenj, ndërsa 19 prej tyre në gropa septike dhe 7 në lokacione të tjera.




**Grafiku 4:** Nr i OE sipas vend-shkarkimit të ujërave të zeza

Në kuadër të KEK-ut ekzistojnë edhe 19 vend shkarkime të ujërave industriale të cilat shkarkohen në lumin Sitnica. Asnjë nga operatorët ekonomik nuk kryen trajtim adekuat për cilësinë e ujërave të përdorura para hedhjes së tyre në rrjedhat sipërfaqësore.




**Foto 6.** Shkarkimi i ujërave industriale nga KEK-u



**Grafiku 5:** Nr i OE me shkarkim të ujërave industriale


Nga grafiku nr. 5 shihet se numri më i madh i operatorëve ekonomik me veprimtari industriale, shkarkimin e ujërave e bëjnë në rrjetin e kanalizimeve kolektive, pa trajtim adekuat ose vetëm trajtim të pjesërishtëm.



**Grafiku 6:** Nr i OE me shkarkim të ujërave shtëpiake

Nga grafiku nr. 6 vërehet se rreth 73% e operatorëve ekonomik nga aglomeracioni i inventarizuar, ujërat e zeza i derdhin në kanalizim, 8.8% i derdhin në lumenj 13.2% në gropa septike dhe 4.4% të tyre në lokacione të tjera.

Asnjë nga operatorët ekonomik nuk kryejnë trajtim të plotë të ujërave të zeza.



**Harta 8.** Pushtet dhe vend-shkarkimet e ujërave të zeza

## 6.5. NDOTJA E TOKËS


Nga numri i përgjithshëm i kompanive, 52 janë me ndikim në ndotjen e tokës, në kuadër të të cilave hyjnë: rezervarët e produkteve të naftës, deponitë e metaleve dhe baterive, vendet e hedhjes së vajrave të ndryshme etj. Në kuadër të KEK-ut, sipërfaqe të mëdha janë të mbuluara nga deponitë e hirit dhe degradohen nga mihjet sipërfaqësore. Përveç kësaj, toka ndotet edhe nga produktet e vajrave të ndryshme dhe mbeturinat e rrezikshme, të cilat janë të deponuara në disa vende.



**Foto 3 dhe 4.** Ndotja e tokave nga hedhja e vajrave dhe deponitë e hirit të KEK-ut

## 6.6. Menaxhimi i mbeturinave


Vetëm 53 operatorë ekonomik disponojnë kontrata me kompani për grumbullimin e mbeturinave, kurse të tjerat janë vetorganizuar në bartjen e mbeturinave, ose mbeturinat i hedhin në vende të ndryshme. Gjithashtu mbeturinat nuk klasifikohen, por të gjitha së bashku si ato shtëpiake, mjekësore, industriale, hedhen në të njëjtën deponi .



**Grafiku 5.** Numri i OE, me kontrata për grumbullimin e mbeturinave



**Foto 5.** Grumbullimi i mbeturinave



Harta 9. Shpërndarja e deponive në komunën e aglomeracionin e hulumtuar

## 7. REKOMANDIMET

- Operatorët ekonomik si potencial ndotës duhet të pajisen me leje mjedisore dhe leje ujore;
- Të obligohen operatorët ekonomik për trajtimin e ujërave të përdorura para derdhjes së tyre në rrjedhat e ujërave sipërfaqësore;
- Të obligohen operatorët ekonomik për monitorimin e kualitetit të ujërave të përdorura para derdhjes së tyre në rrjedhat e ujërave sipërfaqësore dhe raportimin e këtyre të dhënave;
- Të obligohen operatorët ekonomik për hartimin e planeve për menaxhimin e aksidenteve (emergjencave);
- Të obligohen operatorët ekonomik për rehabilitimin (revitalizimin) e sipërfaqeve të ndotura të tokës si pasojë e veprimtarisë së tyre;
- Të obligohen operatorët ekonomik për lidhjen e kontratave me kompanitë regjionale për grumbullimin e mbeturinave;
- Kompanitë për mbledhjen e mbeturinave të raportojnë në AKMM, në lidhje me sasinë, llojin dhe deponimin e mbeturinave;
- Kompanitë dhe operatorët ekonomik duhet të bëjnë klasifikimin e mbeturinave sipas përbërjes dhe llojit.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

---

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*



*Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit*

*Rr. "Bill Clinton" Nr. 18 Prishtinë;*

*Tel. +381 38/ 227- 026; +381 38/227-027;*

*Tel/Fax. +381 38 211 685*

*Email: kepa@ks-gov.net*

*Këtë raport, publikime të tjera nga AKMM si dhe shumë informacione  
për mjedisin mund t'i gjeni në ueb faqen:*

*<http://www.akmm-rks.net>*

---

